- 8.** Antitropi ose fragmenti antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-7 që shprehet nga një qelizë vezore e një hamsteri (brejtës) kinez.
- 9.** Antitropi ose fragmenti antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-7 që është i glikosiluar me një ose më shumë glikane CHO N-të lidhur që janë G0-F, G1 -F, G2-F, G0, G1, G2 ose Man5.
- 10.** Një përbërje që përmban antitropin ose fragmentin antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri 9 dhe një bartës ose tretës farmaceutikisht të pranueshëm.
- 11.** Një përbërje sipas pretendimit 10 që përmban edhe një antitrop anti-PD-1.
- 12.** Përbërja sipas pretendimit 11, ku antitropi anti-PD-1 është Pembrolizumab.
- 13.** Një pajisje injektimi që përmban antitropin ose fragmentin antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9, ose një përbërje sipas cilitdo prej pretendimeve 10-12.

14. Një polinukleotid që kodon: rajonin e ndryshueshëm të zinxhirit të lehtë dhe rajonin e ndryshueshëm të zinxhirit të rëndë ose imunoglobulinën e zinxhirit të lehtë dhe imunoglobulinën e zinxhirit të rëndë të antitropave ose fragmenteve antigjen-lidhëse sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9.

15. Një vektor që përfshin polinukleotidin sipas pretendimit 14.

16. Një qelizë bujtëse që përfshin antitropin ose fragmentin antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9, polinukleotidin sipas pretendimit 14 ose vektorin sipas pretendimit 15.

17. Një metodë për prodhimin e një antitropi ose fragmenti antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9 që përfshin:

- a. kulturimin e një qelize bujtëse që përfshin një polinukleotid që kodon një imunoglobulinë të zinxhirit të lehtë dhe një imunoglobulinë të zinxhirit të rëndë të antitropit, ose një rajon të ndryshueshëm të zinxhirit të lehtë dhe një rajon të ndryshueshëm të zinxhirit të rëndë të fragmentit antigjen-lidhës në një mjedis kulture në kushte të favorshme për shprehjen e polinukleotidit; dhe
- b. jodetyrimisht, nxjerrjen e antitropit ose fragmentit antigjen-lidhës nga qeliza bujtëse dhe/ose mjedisi i kulturës.

18. Metoda sipas pretendimit 17, ku qeliza bujtëse është një qelizë vezore e një hamsteri kinez.

19. Një antitrop ose fragment antigjen-lidhës i tij që lidhet në mënyrë specifike te LAG3 njerëzor që është produkt i metodës sipas pretendimit 17 ose 18.

20. Një antitrop ose fragment antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9, ose përbërja sipas cilitdo prej pretendimeve 10-12, për përdorim në mjekimin e trupit njerëzor me terapi.

21. Një antitrop ose fragment antigjen-lidhës sipas cilitdo prej pretendimeve 1-9 ose përbërja sipas cilitdo prej pretendimeve 10-12, për përdorim në mjekimin e kancerit.

(11) **9898**

(97) EP3006454 / 13/01/2021

(96) 14807973.4 / 03/06/2014

(22) 05/02/2021

(21) AL/P/ 2021/93

(54) **PËRBËRJE TË REJA QË KANË AKTIVITETE TË TREFISHTA TË TROMBOLIZËS, PASTRIMIT ANTITROMBOTIK DHE RADIKAL, DHE SINTEZËS, STRUKTURËS NANO DHE PËRDORIMIT TË TYRE**

05/05/2021

(30) 201310225330 05/06/2013 CN

(71) Shanghai Lumosa Therapeutics Co., Ltd.

Room 3026, 3rd Floor, Building 1, No. 146, 1st East Fute Road, Shanghai Pilot Free Trade Zone, Shanghai 200131, CN




(72) PENG, Shiqi (Room 5, 9th Floor, Building 26, No. 38 Xueyuan Rd., Haidian District, Beijing 100083); ZHAO, Ming (Room 401, Building C, Yulin Community, Fengtai District, Beijing 100069); WU, Jianhui (No.10 Xitoutiao, You An Men Wai, Fengtai District, Beijing 100069); WANG, Yuji (No.10 Xitoutiao, You An Men Wai, Fengtai District, Beijing 100069); FENG, Qiqi (No.10 Xitoutiao, You An Men Wai, Fengtai District, Beijing 100069)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57) 1. Një përbërje e formulës I:



ku T përfaqëson një krah lidhës që ka të paktën dy grupe për lidhje;

Q përfaqëson një peptid që ka aktivitet trombolitik; dhe


R<sub>1</sub> dhe R<sub>2</sub> përfaqësojnë grupet C<sub>1-4</sub> alkil, ku R<sub>1</sub> dhe R<sub>2</sub> janë të njëjtë ose të ndryshëm;

ku të paktën një prej grupeve për lidhje është një grup amino dhe grupet që mbeten për lidhje janë grupe karboksil ose grupe amino; dhe

ku peptidi që ka aktivitet trombolitik është zgjedhur nga grupi i përbërë prej një oligopeptidi që përmban një sekuencë PA (Pro-Ala), një sekuencë PAK (Pro-Ala-Lis), një sekuencë AKP (Ala-Lis-Pro) ose një sekuencë KAP (Lis-Ala-Pro), dhe një peptid që ka njësi të përsëritura të sekuencës PAK, sekuencës AKP ose sekuencës KAP.

2. Përbërja e pretendimit 1, ku krahu lidhës është L-Lis, L-Asp, ose L-Glu.

3. Përbërja e pretendimit 1, ku oligopeptidi që ka sekuencën PA (Pro-Ala) është një tripeptid që ka formulën e mëposhtme Q1 ose Q2:











ku AA është zgjedhur nga grupi i përbërë prej L-Ala, L-Val, L-Trp, L-Tir, L-Pro, L-Phe, Gli, L-Ser, L-Ile, L-Thr, L-Lis, L-Leu, L-Gln, L-Asn, L-Asp, dhe L-Glu.

4. Përbërja e pretendimit 1, ku R<sub>1</sub> dhe R<sub>2</sub> janë të dy grupe metil.

5. Përbërja e pretendimit 4, ku krahu lidhës është L-Lis, L-Asp, ose L-Glu, dhe peptidi që ka aktivitet trombolitik është një tripeptid që ka një sekuencë PA (Pro-Ala).


6. Përbërja e pretendimit 5, ku përbërja ka formulën e mëposhtme Ia, Ib, Ic, Id, Ie, If, Ig, ose Ih:





ku AA është zgjedhur nga një grup i përbërë prej L-Ala, L-Val, L-Trp, L-Tir, L-Pro, L-Phe, Gli, L-Ser, L-Ile, L-Thr, L-Lis, L-Leu, L-Gln, L-Asn , L-Asp, dhe L-Glu.

7. Përbërja e pretendimit 6, ku përbërja ka formulën e mëposhtme Ia:



ku AA është L-Lis.

8. Një kompozim farmaceutik, që përfshin përbërjen e çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 7, dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

9. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 8, ku përbërja është në formën e një strukture nanosferike.

10. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 8 për përdorim si një ilaç trombolitik, një ilaç radikal pastrues pa NO, ose një ilaç antitrombotik.

11. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 8 për përdorim si ilaç në trajtimin e goditjes në tru ose infarktit cerebral.

12. Një metodë përgatitje e një përbërje që ka formulën I të pretendimit 1, që përfshin hapat e mëposhtëm:

(1) sigurimin e një përbërje që ka formulën e mëposhtme II:



(2) sigurimin e krahut lidhës T që ka të paktën dy grupe për lidhje, dhe peptidi Q që ka aktivitet trombolitik, ku krahu lidhës që ka një grup të parë për lidhje dhe një grup të dytë për lidhje;

Oc1cc(O)ccc2c1CC(N)C(=O)T(C2)R1R2 (IM-1)

(4) bashkimin e peptidit Q që ka aktivitet trombolitik me përbërjen që ka formulën IM-1 në një gjendje reagimi të përshtatshme, ku një terminal i peptidit Q që ka aktivitet trombolitik është bashkuar me grupin e dytë për lidhjen e krahut lidhës T për të formuar përbërjen që ka formulën I.

**14.** Metoda e përgatitjes e pretendimit 12, ku peptidi që ka aktivitet trombolitik është zgjedhur nga grupi i përbërë prej një oligopeptidi që ka një sekuencë PA (Pro-Ala), një sekuencë PAK (Pro-Ala-Lis), një sekuencë AKP (Ala-Lis-Pro) ose një sekuencë KAP (Lis-Ala-Pro), dhe një peptid që ka njësi të përsëritura të sekuencës PAK, sekuencës AKP ose sekuencës KAP.

(11) **9899**

(97) EP3495495 / 23/12/2020

(96) 18192236.0 / 27/11/2013

(22) 05/02/2021

(21) AL/P/ 2021/94

(54) **SHËNJUES DIAGNOSTIKUES PËR TRAJTIMIN E ÇRREGULLIMEVE PROLIFERATIVE TË QELIZAVE ME FRENUES TELOMERAZË**

05/05/2021

(30) 201261732263 P 30/11/2012 US; 201313802035 13/03/2013 US; 201361780851 P 13/03/2013 US; 201361798478 P 15/03/2013 US and 201361809228 P 05/04/2013 US

(71) Geron Corporation

919 E. Hillsdale Blvd., Foster City, CA 94404, US

(72) BASSETT, Ekaterina (405 Rancho Arroyo Pkwy, Apt. 48, Fremont, CA 94536-2720); BURINGTON, Bart (1 Kingwood Road, Oakland, CA 94619); WANG, Hui (1684 Belleville Way, Sunnyvale, CA 94087) ;ENG, Kevin (1571 Hyde Drive, Los Gatos CA 95032)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57) **1.** Një metodë për zgjedhjen e një individi të diagnostikuar me ose të dyshuar që ka kancer i cili do të përfitojë nga trajtimi me një frenues telomerazë, metoda që përfshin:

(a) përcaktimin e gjatësisë relative telomere duke analizuar gjatësinë relative të acideve nukleike telomerike në qelizat kancerogjene të pranishme në një mostër biologjike nga individi; dhe

(b) zgjedhjen e një individi i cili do të përfitojë nga trajtimi me një frenues telomerazë kur gjatësia mesatare relative e telomeres në qelizat kancerogjene të pranishme në mostrën biologjike nga individi përcaktohet të jetë në përqindjen e 50<sup>të</sup> ose më pak të një rangu relativ të gjatësisë telomere të përcaktuar nga një ose më shumë standarde të njohura, ku:

një ose më shumë standarde të njohura është një rang i gjatësisë telomere i krijuar nga një shumësi tumoresh që ndodhin në mënyrë natyrale nga një shumësi individësh ku qelizat kancerogjene nga shumësia e tumoreve që ndodhin në mënyrë natyrale janë të njëjtë lloj me qelizat kancerogjene të pranishme në mostrën biologjike nga individi i diagnostikuar me kancer; ose një ose më shumë standarde të njohura janë linja qelizore të karakterizuara.

**2.** Një frenues telomerazë për përdorim në trajtimin e një individi me ose të dyshuar që ka kancer kur gjatësia mesatare relative e telomeres në qelizat kancerogjene të pranishme në një mostër biologjike nga individi është përcaktuar të jetë në përqindjen e 50-të ose më pak të një rangu relativ të gjatësisë së telomeres të përcaktuar nga një ose më shumë standarde të njohura, ku:

një ose më shumë standarde të njohura është një rang i gjatësisë telomere i krijuar nga një shumësi tumoresh që ndodhin në mënyrë natyrale nga një shumësi

individësh ku qelizat kancerogjene nga shumësia e tumoreve që ndodhin në mënyrë natyrale janë të të njëjtit lloj me qelizat kancerogjene të pranishme në mostrën biologjike nga individi i diagnostikuar me kancer; ose një ose më shumë standarde të njohura janë linja qelizore të karakterizuara.

- 3.** Frenuesi telomerazë për përdorim i pretendimit 2, ku frenuesi telomerazë përfshin një oligonukleotid.
- 4.** Frenuesi telomerazë për përdorim i pretendimit 3, ku oligonukleotidi është komplementar me përbërësin ARN të telomerazës.
- 5.** Frenuesi telomerazë për përdorim i pretendimit 4, ku oligonukleotidi është 10-20 çifte bazash në gjatësi dhe përfshin të paktën një lidhje  $N3' \rightarrow P5'$  tiofosforamidate internukleozide.
- 6.** Frenuesi telomerazë për përdorim i pretendimit 4, ku frenuesi telomerazë është Imetelstat.
- 7.** Frenuesi telomerazë për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 2 deri në 6, ku kanceri është kancer i mushkërive me qeliza jo të vogla, kancer i mushkërive me qeliza të vogla, kancer i fshikëzës, kancer i sipërm gastrointestinal, kancer i stomakut, kancer i fshikëzës së tëmthit, kancer i vezoreve, glioblastoma, një sarkomë ose një kancer hematologjik.
- 8.** Frenuesi telomerazë për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 2 deri në 7, ku frenuesi telomerazë administrohet me një ekscipient farmaceutikisht të pranueshëm.
- 9.** Frenuesi telomerazë për përdorim i pretendimeve 2 deri në 8, ku gjatësia telomere në qelizat kancerogjene të pranishme në mostrën biologjike përcaktohet të jetë në përqindjen e 40-të, përqindjen e 35-të, përqindjen e 30-të, përqindjen e 25-të, përqindjen e 20-të, përqindjen e 15-të, përqindjen e 10-të, ose përqindjen e 5-të ose më pak e rangut relativ të gjatësisë së telomeres.
- 10.** Metoda e pretendimit 1, ku kanceri është kancer i mushkërive me qeliza jo të vogla, kancer i mushkërive me qeliza të vogla, kancer i fshikëzës, kancer i sipërm gastrointestinal, kancer i stomakut, kancer i fshikëzës së tëmthit, kancer i vezoreve, glioblastoma, një sarkomë ose një kancer hematologjik.
- 11.** Metoda e pretendimit 1 ose pretendimit 10, që përfshin më tej administrimin te individi të një sasive efektive në mënyrë terapeutike të një ose më shumë agjentëve shtesë terapeutikë të kancerit.
- 12.** Metoda e pretendimit 1, pretendimit 10 ose pretendimit 11, ku gjatësia mesatare e telomeres përcaktohet nga qPCR, telo-FISH, ose Southern Blot.

**13.** Metoda e pretendimit 1 ose çdonjërit prej pretendimeve 10 deri në 12, ku individi është njeri.

**14.** Metoda e pretendimit 1 ose çdonjërit prej pretendimeve 10 deri në 13, ku një ose më shumë standarde të njohura të sipërpërmendura janë linja qelizore të karakterizuara, në mënyrë opsionale ku linjat qelizore janë zgjedhur nga grupi i përbërë prej: qelizave M14, qelizave A549, qelizave SK-5, dhe qelizave Ovcar5.

**15.** Metoda e pretendimit 14, ku linjat qelizore të karakterizuara janë zgjedhur nga linjat qelizore përfaqësuese të llojit të mostrës biologjike të pretendimit 1, në mënyrë opsionale ku linjat qelizore të karakterizuara janë linja qelizore të kancerit të mushkërive më qeliza jo të vogla, linja qelizore hepatocelulare, ose linja qelizore të vezoreve.

**16.** Metoda e pretendimit 1 ose e çdonjërit prej pretendimeve 10 deri në 15, ku gjatësia telomere në qelizat kancerogjene të pranishme në mostrën biologjike përcaktohet të jetë në përqindjen e 40-të, përqindja e 35-të, përqindja e 30<sup>të</sup>, përqindja e 25-të, përqindja e 20-të, përqindja e 15-të, përqindja e 10-të, ose përqindja e 5-të ose më pak e rangut të gjatësisë relative të telomeres.

(11) **9900**

(97) EP3313436 / 23/12/2020

(96) 16753710.9 / 21/06/2016

(22) 05/02/2021

(21) AL/P/ 2021/95

(54) **VAKSINA E KONJUGUAR PNEUMOKOKSIKE SHUMËVALENTE**

05/05/2021

(30) 3140CH2015 23/06/2015 IN

(71) Biological E Limited

18/1 & 3 Azamabad, Telangana, Hyderabad 500020, IN

(72) MATUR, RAMESH Venkat (Biological E Ltd., 18/1&3, Azamabad, Hyderabad Telangana 500020); THIRUMENI, Nagarajan (Biological E Ltd., 18/1&3, Azamabad, Hyderabad Telangana 500020); BURKI, Rajendar (Biological E Ltd., 18/1 & 3 Azamabad, Hyderabad Telangana 500020); MANTENA, NARENDER, Dev (Biological E Ltd., 18/1&3, Azamabad, Hyderabad Telangana 500020) ;DATLA, Mahima (Biological E Ltd., 18/1&3, Azamabad, Hyderabad Telangana 500020)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57) **1.** Një kompozim i vaksinës së konjuguar Pneumokoksike shumëvalente (PCV) i përbërë prej:

a1) të paktën 12 polisakaride kapsulare të zgjedhura nga serotipet 1, 3, 4, 5, 6B, 7F, 9N, 9V, 15B, 14, 18C, 19A, 19F, 22F, 23F dhe 33F të *S. pneumoniae* të aktivizuara me CDAP dhe të konjuguara me proteina mbartëse të zgjedhura nga CRM<sub>197</sub>,

proteina sipërfaqësore pneumokoksike A (PspA), proteina të ngjitjes pneumokoksike (PsaA) ose kombinim i tyre, dhe në mënyrë opsionale një ose më shumë serotipe të zgjedhura nga 6C, 8, 10A, 11A, 12F, 15A, 23A, 23B dhe 35B të *S. pneumoniae*; ose

a2) të paktën 14 polisakaride kapsulare të zgjedhura nga serotipet 1, 3, 4, 5, 6B, 7F, 9N, 9V, 14, 15B, 18C, 19A, 19F, 22F, 23F dhe 33F të *S. pneumoniae* të aktivizuara me CDAP dhe të konjuguara me CRM<sub>197</sub>, PspA, PsaA ose kombinim i tyre, dhe në mënyrë opsionale një ose më shumë serotipe të zgjedhura nga 6C, 8, 10A, 11A, 12F, 15A, 23A, 23B dhe 35B të *S. pneumoniae*; dhe

b) një mbartës farmaceutikisht I pranueshëm; dhe

në mënyrë opsionale një tretës ose mjet farmaceutikisht i pranueshëm; dhe

në mënyrë opsionale përbërësit,

ku kompozimi përmban polisakaride kapsulare nga serotipet 22F dhe 33F dhe nuk përmban polisakaride kapsulare nga serotipi 6A.

2. Kompozimi siç pretendohet ne pretendimin 1, ku sasia e polisakaridit nga secili prej serotipeve është 1 deri në 10 µg.

3. Kompozimi siç pretendohet ne pretendimin 1, ku sasia e proteinave mbartëse të konjuguara me polisakaride është 3 deri në 30 µg.

4. Kompozimi siç pretendohet ne pretendimin 1, ku një dozë e vetme 0.5 mL përmban 2 µg prej secilit polisakarid; 30-40 µg CRM<sub>197</sub> proteinë mbartëse; 0.2 deri në 1 mg ndihmës fosfat alumini; klorur natriumi dhe tampon.

5. Një formulim i vaksinës së konjuguar Pneumokoksike (PCV) të lëngshme sterile 14 valent që përfshin 2 µg prej secilit polisakarid kapsular të serotipeve 1, 3, 4, 5, 7F, 9V, 14, 18C, 19A, 19F, 22F, 23F dhe 33F, 4 µg prej serotipeve 6B secili në mënyrë individuale i konjuguar me 32 µg CRM<sub>197</sub>; 0.125 mg ndihmës elementar të aluminit (0.5 mg fosfat alumini); dhe klorur natriumi dhe tampon L-histidin, ku formulimi nuk përmban



polisakaride kapsulare nga serotipi 6A.

**6.** Një formulim i vaksinës së konjuguar Pneumokoksike (PCV) të lëngshme sterile 13 valent që përfshin 2 µg prej secilit polisakarid kapsular të serotipeve 1, 3, 4, 5, 7F, 9V, 14, 18C, 19A, 19F, 22 F dhe 33F, 4 µg prej serotipit 6B secili në mënyrë individuale i konjuguar me 32 µg CRM<sub>197</sub>; 0.125 mg ndihmës elementar të aluminit (0.5 mg fosfat alumini); dhe klorur natriumi dhe tampon L-histidin, ku formulimi nuk përmban polisakaride kapsulare nga serotipi 6A.

**7.** Një metodë për formulimin e formulimit të PCV 13 valent sipas pretendimit 6, që përfshin hapat e:

- a) konjugimit të polisakarideve kapsulare pneumokoksike me madhësi të njohur nga serotipet 1, 3, 4, 5, 6B, 7F, 9V, 14, 18C, 19A, 19F, 22F dhe 33F aktivizuar duke shfrytëzuar CDAP, në mënyrë individuale me proteina mbartëse imunogjene CRM<sub>197</sub>,
- b) diafiltrimit të konjugatëve individualë monovalent pneumokoksike të ndjekur nga pastrimi duke përdorur kromatografinë e përjashtimit të madhësisë,
- c) analizës së fraksioneve nga SEC-HPLC dhe grumbullimit të fraksioneve që përmbajnë konjugatë monovalent pneumokoksike përpara sterilizimit të filtrit duke përdorur filtër 0.2 µm,
- d) formulimit të PCV 13 valent duke përdorur 13 konjugatë monovalent pneumokoksike; 4.4 µg për serotipin 6B; 2.2 µg për pjesën tjetër të serotipeve dhe ndihmësin Adju-Phos® së bashku me eksipientin e duhur që përmban klorur natriumi dhe tamponin që përmban L-histidin të ndjekur nga mbushja aseptike,

ku formulimi i PCV 13 valent i sipërpërmendur nuk përmban polisakaride kapsulare nga serotipi 6A.

**8.** Një metodë për formulimin e formulimit të PCV 14 valent sipas pretendimit 5 që përfshin hapat e:

- a) konjugimit të polisakarideve kapsulare pneumokoksike me madhësi të njohur nga serotipet e aktivizuar 1, 3, 4, 5, 6B, 7F, 9V, 14, 18C, 19A, 19F, 22F, 23F dhe 33F duke shfrytëzuar CDAP, në mënyrë individuale me proteina mbartëse imunogjene CRM<sub>197</sub>,
- b) diafiltrimit të konjugatëve individual monovalent pneumokoksike të ndjekur nga pastrimi duke përdorur kromatografisë e përjashtimit të madhësisë,
- c) analizës së fraksioneve nga SEC-HPLC dhe grumbullimit të fraksioneve që përmbajnë konjugatë monovalent pneumokoksike përpara sterilizimit të filtrit duke përdorur filtër 0.2 µm dhe
- d) formulimit të PCV 14 valent duke përdorur konjugatë monovalent pneumokoksike; 4.4 µg për serotipin 6B; 2.2 µg për pjesën tjetër të serotipeve dhe ndihmësin Adju-Phos® së bashku me eksipientin e duhur që përmban klorur natriumi dhe tamponin që përmban L-histidin të ndjekur nga mbushja aseptike,

ku formulimi i PCV 14 valent i sipërpërmendur nuk përmban polisakaride kapsulare nga serotipi 6A.

(11) **9903**

(97) EP3593808 / 09/12/2020

(96) 19191396.1 / 10/12/2015

(22) 09/02/2021

(21) AL/P/ 2021/101

(54) **POLIMERE PROTON-LIDHËSE PËR ADMINISTRIM ORAL**

06/05/2021

(30) 201462090287 P 10/12/2014 US

(71) Tricida Inc.

7000 Shoreline Court, Suite 201, South San Francisco, CA 94080, US

(72) KLAERNER, Gerrit (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); CONNOR, Eric F. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); GBUR, Randi K. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); KADE, Matthew J. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); KIERSTEAD, Paul H. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); BUYSSE, Jerry M. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California

94080); COPE, Michael J. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); BIYANI, Kalpesh N. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); NGUYEN, Son H. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080); TABAKMAN, Scott M. (c/o TRICIDA INC. 7000 Shoreline Court Suite 201, South San Francisco, CA California 94080)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë, 100

(57) Një përbërje farmaceutike që përmban një polimer amine të rrjetëzuar që ka një raport të aftësisë lidhëse të jonit të klorurit ndaj aftësisë lidhëse të jonit të fosfatit në Amortizuesin Inorganik të Zorrëve të Vogla të Simuluar ("SIB") prej të paktën 2.3:1, përkatësisht, ku amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>, dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5, dhe raporti i aftësisë lidhëse të jonit të klorurit ndaj aftësisë lidhëse të jonit të fosfatit në SIB përcaktohet duke përdorur metodën e shpalosur në përshkrimin nën emërtimin Metoda B.

2. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka një raport të aftësisë lidhëse të jonit të klorurit ndaj aftësisë lidhëse të jonit të fosfatit në SIB prej të paktën 2.5:1, përkatësisht, ku amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>, dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5.
3. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1 ose 2, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka një raport të aftësisë lidhëse të jonit të klorurit ndaj aftësisë lidhëse të jonit të fosfatit në SIB prej:

- (i) të paktën 3:1,
- (ii) të paktën 3.5:1, ose
- (iii) të paktën 4:1;

përkatësisht, ku amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>, dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5.

4. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka një aftësi lidhëse të jonit të klorurit prej:
- (i) të paktën 4 mmol/g,
  - (ii) të paktën 4.5 mmol/g,
  - (iii) të paktën 5 mmol/g,
  - (iv) të paktën 5.5 mmol/g, ose
  - (v) të paktën 6 mmol/g;

në SIB, ku amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM  $\text{NaH}_2\text{PO}_4$ , dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5, dhe aftësia lidhëse e jonit të klorurit në SIB është përcaktuar duke përdorur metodën e shpalosur në përshkrimin nën emërtimin Metoda B.

5. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka një Raport Fryrjeje prej:

- (i) më pak se 5,
- (ii) më pak se 4,
- (iii) më pak se 3,
- (iv) më pak se 2,
- (v) më pak se 1.5, ose
- (vi) më pak se 1.

6. Përbërja farmaceutike e secilit pretendim të mëparshëm, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka një aftësi lidhëse të jonit të klorurit prej të paktën 5 mmol/g në një Analizë të Lëngut Gastrik të Simuluar ("SGF") 1-orëshe dhe një aftësi lidhëse të jonit të klorurit prej:

- (i) të paktën 8 mmol/g,
- (ii) të paktën 9 mmol/g,
- (iii) të paktën 10 mmol/g,
- (iv) të paktën 11 mmol/g,
- (v) të paktën 12 mmol/g,
- (vi) të paktën 13 mmol/g, ose
- (vii) të paktën 14 mmol/g;

në një Analizë SGF 24-orëshe,  
ku SGF konsiston në 35 mM NaCl, 63 mM HCl, pH 1.2, dhe aftësia lidhëse e jonit të klorurit në Analizën SGF është përcaktuar duke përdorur metodën e shpalosur në përshkrimin nën emërtimin Metoda A.

7. Përbërja farmaceutike e secilit pretendim të mëparshëm, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka (i) një aftësi lidhëse të protonit dhe një aftësi lidhëse të klorurit prej të paktën 5 mmol/g në Lëngun Gastrik të Simuluar (SGF); dhe (ii) një aftësi lidhëse të jonit të klorurit në 1 orë në SIB prej:


- (a) të paktën 2 mmol/g,
- (b) të paktën 2.5 mmol/g, ose
- (c) të paktën 3 mmol/g;

ku SGF konsiston në 35 mM NaCl, 63 mM HCl, pH 1.2, dhe aftësia lidhëse e protonit dhe aftësia lidhëse e klorurit në SGF është përcaktuar duke përdorur

metodën e shfaqur në përshkrimin nën emërtimin Metoda A, dhe amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>, dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5, dhe aftësia lidhëse e jonit të klorurit në SIB është përcaktuar duke përdorur metodën e shpalosur në përshkrimin nën emërtimin Metoda B.

8. Përbërja farmaceutike e secilit pretendimit të mëparshëm, ku polimeri aminë i rrjetëzuar ka (i) një aftësi lidhëse të protonit dhe një aftësi lidhëse të klorurit prej të paktën 5 mmol/g në Lëng Gastrik të Simuluar (SGF); dhe (ii) një aftësi lidhëse të jonit të klorurit prej të paktën 4 mmol/g në 1 orë në SIB, ku SGF konsiston në 35 mM NaCl, 63 mM HCl, pH 1.2, dhe aftësia lidhëse e protonit dhe aftësia lidhëse e klorurit në SGF është përcaktuar duke përdorur metodën e shfaqur në përshkrimin nën emërtimin Metoda A, dhe amortizuesi i përdorur për analizën SIB përmban 36 mM NaCl, 20 mM NaH<sub>2</sub>PO<sub>4</sub>, dhe 50 mM acid 2-(N-morfolino)etansulfonik (MES) të amortizuar në pH 5.5, dhe aftësia lidhëse e jonit të klorurit në SIB është përcaktuar duke përdorur metodën e shpalosur në përshkrimin nën emërtimin Metoda B.
9. Përbërja farmaceutike e secilit pretendim të mëparshëm, ku polimeri aminë i rrjetëzuar është përgatitur nëpërmjet një procesi që përmban rrjetëzimin e një polimeri aminë të paraformuar në një përzierje reaksioni që përmban polimerin aminë të paraformuar, një tretës, një agjent të rrjetëzuar, dhe një agjent fryrës për polimerin aminë të paraformuar, ku agjenti fryrës preferueshëm është i papërziesshëm me tretësin, polimeri aminë i paraformuar ka një aftësi thithëse për agjentin fryrës, dhe sasia e agjentit fryrës në përzierjen e reaksionit është më pak se aftësia thithëse e polimerit aminë të paraformuar për agjentin thithës.
10. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1-8, ku polimeri aminë i rrjetëzuar është përgatitur nëpërmjet një procesi që përmban dy hapa të veçantë polimerizimi/rrjetëzimi, ku
  - 1) në hapin e parë, një polimer aminë i paraformuar që ka një aftësi lidhëse të klorurit prej të paktën 10 mmol/g në Lëngun Gastrik të Simuluar ("SGF") dhe është formuar një Raport Fryrjeje që varion nga 2 deri në 10, dhe polimeri aminë i paraformuar është (të paktën pjesërisht) i çprotonizuar me një bazë dhe i kontaktuar me një agjent fryrës për të fryrë polimerin aminë të paraformuar të çprotonizuar, dhe
  - 2) në hapin e dytë, polimeri aminë i paraformuar i çprotonizuar është rrjetëzuar me një agjent të rrjetëzuar që përmban grupet funksionale reaguese aminë për të formuar polimerin aminë të rrjetëzuar.


11. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1-10, ku polimeri aminë i paraformuar është një polimer aminë i rrjetëzuar që përmban mbetjen e një amine që i korrespondon Formulës 2:



Formula 2


ku

m dhe n janë në mënyrë të pavarur numra të plotë jo-negative;  
 $R_{10}$ ,  $R_{20}$ ,  $R_{30}$ , dhe  $R_{40}$  janë në mënyrë të pavarur hidrogjen, hidrokarbil, ose hidrokarbil i zëvendësuar;  
 $X_1$  është



$X_2$  është hidrokarbil ose hidrokarbil i zëvendësuar;  
secili  $X_{11}$  është në mënyrë të pavarur hidrogjen, hidrokarbil, hidrokarbil i zëvendësuar, hidroksil, amino, acid boronik, ose halo; dhe  
z është një numër jo-negativ.


11. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1-10, ku polimeri aminë i paraformuar është një polimer aminë i rrjetëzuar që përmban mbetjen e një amine që korrespondon me Formulën 2b dhe polimeri aminë i rrjetëzuar është përgatitur nga polimerizimi radikal i një amine që korrespondon me Formulën 2b:



Formula 2b

ku

m dhe n janë në mënyrë të pavarur numra jo-negative;  
 secili  $\text{R}_{12}$  është në mënyrë të pavarur hidrogjen, hidrokarbil i zëvendësuar, ose hidrokarbil;  
 $\text{R}_{22}$  dhe  $\text{R}_{32}$  janë në mënyrë të pavarur hidrogjen, hidrokarbil i zëvendësuar, ose hidrokarbil;  
 $\text{R}_{42}$  është hidrogjen, hidrokarbil ose hidrokarbil i zëvendësuar;  
 $\text{X}_1$  është



$\text{X}_2$  është alkil, aminoalkil, ose alkanol;  
 secili  $\text{X}_{13}$  është në mënyrë të pavarur hidrogjen, hidroksi, aliciklik, amino, aminoalkil, halogjen, alkil, heteroaril, acid boronik ose aril;  
 z është një numër jo-negativ, dhe  
 amina që korrespondon me Formulën 2b përmban të paktën një grup alil.

13. Përbërja farmaceutike e pretendimit 12, ku polimeri aminë i rrjetëzuar është përgatitur nëpërmjet polimerizimit radikal të një amine që korrespondon me Formulën 2b, dhe m dhe z janë në mënyrë të pavarur 0, 1, 2 ose 3, dhe n është 0 ose 1.
14. Përbërja farmaceutike e pretendimit 12, ku m është një numër i plotë pozitiv, n është një numër i plotë pozitiv dhe  $\text{R}_{12}$ ,  $\text{R}_{22}$ ,  $\text{R}_{32}$  dhe  $\text{R}_{42}$ , në kombinim, përmbajnë të paktën dy grupe funksionale alili ose vinili.
15. Përbërja farmaceutike e pretendimit 12, ku një polimer i përshkruar nga Formula 2b është i sintetizuar nga aminat dhe rrjetëzuesit, ose kriperat e tyre,

të përzgjedhura nga: 1,4-bis(alilamino)butan, 1,2-bis(alilamino)etan, 2-(alilamino)-1-[2-(alilamino)etilamino]etan, 1,3-bis(alilamino)propan, 1,3-bis(alilamino)-2-propanol, 2-propen-1-ilaminë, 1-(alilamino)-2-aminoetan, 1-[N-alil(2-aminoetil)amino]-2-aminoetan, N,N,N-trialilaminë.

- 16.** Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1-15 ku polimeri aminë i rrjetëzuar është rrjetëzuar me një agjent të rrjetëzuar që mund të përdoret në reaksionet e polimerizimit zëvendësues dhe reaksionet e rrjetëzimit të pas-polimerizimit, ku agjenti rrjetëzues është një ose më shumë nga: dihaloalkane, haloalkiloksirane, sulfonate alkiloksirane, di(haloalkil)amina, tri(haloalkil)amina, diepoke, triepoke, tetraepoke, bis (halometil)benzene, tri(halometil)benzene, tetra(halometil)benzene, epihalohidrina të tillë si epiklorohidrinë dhe epibromohidrinë poli(epiklorohidrin), (jodometil)oksiran, glicidil tosilat, glicidil 3-nitrobenzensulfonat, 4-tosiloksi-1,2-epoksibutan, bromo-1,2-epoksibutan, 1,2-dibromoetan, 1,3-dikloropropan, 1,2-dikloroetan, 1-bromo-2-kloroetan, 1,3-dibromopropan, bis(2-kloroetil)aminë, tris(2-kloroetil)aminë, bis(2-kloroetil)metilaminë, 1,3-butadien diepoksidi, 1,5-hekzadien diepoksidi, diglicidil eter, 1,2,7,8-diepoksioktan, 1,2,9,10-diepoksidekan, etilen glikol diglicidil eter, propilen glikol diglicidil eter, 1,4-butandiol diglicidil eter, 1,2-etandiol diglicidil eter, glicerol diglicidil eter, 1,3-diglicidil gliceril eter, N,N-diglicidilanilinë, neopentil glikol diglicidil eter, dietilen glikol diglicidil eter, 1,4-bis(glicidiloksi)benzen, rezorcinol diglicidil eter, 1,6-heksandiol diglicidil eter, trimetilolpropan diglicidil eter, 1,4-cikloheksandimetanol diglicidil eter, acid 1,3-bis-(2,3-epoksipropiloksi)-2-(2,3-dihidroksipropiloksi)propan, 1,2-cikloheksandikarboksilik diglicidil ester, 2,2'-bis(glicidiloksi) difenilmetan, bisfenol F diglicidil eter, 1,4-bis(2',3'-epoksipropil)perfluoro-n-butan, 2,6-di(oksiran-2-ilmetil)-1,2,3,5,6,7-hekzahidropirrololo[3,4-f]izoindol-1,3,5,7-tetraone, bisfenol A diglicidil eter, etil 5-hidroksi-6,8-di(oksiran-2-ilmetil)-4-okso-4-h-kromen-2-karboksilat, bis[4-(2,3-epoksi-propiltio)fenil]-sulfid, 1,3-bis(3-glicidoksi)propil tetrametildisiloksan, 9,9-bis[4-(glicidiloksi)fenil]fluorinë, triepoksiizocianurat, glicerol triglicidil eter, N,N-diglicidil-4-glicidiloksianilinë, acid izocianurik (S,S,S)-triglicidil ester, acid izocianurik (R,R,R)-triglicidil ester, triglicidil izocianurat, trimetilolpropan triglicidil eter, glicerol propoksilat triglicidil eter, trifenilolmetan triglicidil eter, 3,7,14-tris[[3-(epoksipropoksi)propil]dimetilsililoksi]-1,3,5,7,9,11,14-heptaciklopentiltriciklo [7,3,3,15, 11]heptasiloksan, 4,4'-metilenbis(N,N-diglicidilanilinë), bis(halometil)benzen, bis(halometil)bifenil, bis(halometil)naftalen, toluen diizocianat, klorur akriloli, akrilat metili, bisakrilamid etileni, dianhidrid pirometalik, diklorur sukcinili, dimetilsucinat, 3-kloro-1-(3-kloropropilamino)-2-propanol, 1,2-bis(3-kloropropilamino)etan, bis(3-kloropropil)aminë, 1,3-dikloro-2-propanol, 1,3-dikloropropan, 1-kloro-2,3-epoksipropan, tris[(2-oksiranil)metil]aminë.



17. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 9-15, ku agjenti i rrjetëzuar është një agjent i rrjetëzuar i përzgjedhur nga: bis(3-kloropropil)aminë, 1,3-dikloro-2-propanol, 1,2-dikloroetan, 1,3-dikloropropan, 1-kloro-2,3-epoksiopropan, tris[(2-oksiranil)metil]aminë, 3-kloro-1-(3-kloropropilamino)-2-propanol, ose 1,2-bis(3-kloropropilamino)etan.
18. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 9-15, ku agjenti i rrjetëzuar është një dikloroalkan.
19. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 9-15, ku agjenti i rrjetëzuar është dikloroetan ose dikloropropan.
20. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve të mëparshme për tu përdorur në një metodë për të trajtuar acidozën metabolike duke larguar HCl nëpërmjet administrimit oral të përbërjes farmaceutike të përmendur.

(11) **9904**

(97) EP3040076 / 09/12/2020

(96) 15192845.4 / 14/12/2011

(22) 09/02/2021

(21) AL/P/ 2021/102

(54) **NJË KOMPOZIM QË PËRFSHIN NJË ANTIBIOTIK JO-PEPTID DHE CISTEMINË**

06/05/2021

(30) 201021186 14/12/2010 GB and 423000 P 14/12/2010 US

(71) NovaBiotics Limited

Unit 3 Siverburn Crescent, Bridge of Don Industrial Estate, Aberdeen, Scotland AB23 8EW, GB

(72) O'NEIL, Deborah (NovaBiotics Limited The Cruickshank Building, Craibstone, Aberdeen, Aberdeenshire AB21 9TR) ;CHARRIER, Cedric (NovaBiotics Limited The Cruickshank Building, Craibstone, Aberdeen, AB21 9TR)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57) **1.** Një produkt që përfshin një agjent antibiotik dhe cisteminë ku agjenti antibiotik është një antibiotik jo-peptid.

**2.** Një produkt siç pretendohet në pretendimin 1 ku agjenti antibiotik është zgjedhur nga grupi i përbërë prej aminoglikoside, ansamicinë, karbacefem, karbapenem, cefalosporinë,

linkosamide, makrolide, monobaktam, nitrofuran, kuinolone, penicilinë, sulfonamide dhe tetraciklinë.

**3.** Një produkt siç pretendohet në pretendimin 2 ku agjenti antibiotik është zgjedhur nga grupi i përbërë prej aminoglikoside, linkosamide, makrolide, kuinolone, sulfonamide dhe tetraciklinë.

**4.** Një produkt siç pretendohet në pretendimin 1 që përfshin një sasi efektive në mënyrë sinergjike të (i) një agjenti antibiotik, dhe (ii) cisteminë.

**5.** Një produkt siç pretendohet në çdonjë prej pretendimeve të mëparshme për përdorim si një medikament.

**6.** Një substrat te i cili një produkt siç pretendohet në çdonjë prej pretendimeve të mëparshme aplikohet ose bashkëngjitet.

**7.** Një kompozim farmaceutik që përfshin një produkt siç pretendohet në çdonjë prej pretendimeve 1 deri në 5 dhe një ose më shumë diluentë, ekscipientë dhe/ose mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

**8.** Një produkt siç pretendohet në çdonjë prej pretendimeve 1 deri në 4 ose produkti farmaceutik siç pretendohet në pretendimin 7 për përdorim në trajtimin ose parandalimin e një infeksioni mikrobial.

**9.** Produkti për përdorim siç pretendohet në pretendimin 8 ku infeksioni është zgjedhur nga grupi i përbërë prej infeksioneve të lëkurës dhe plagës, infeksioneve të veshit-të mesëm, infeksioneve të traktit gastrointestinal, infeksioneve të membranës peritoneale, infeksioneve të traktit urogjenital, infeksioneve të indeve të buta orale, infeksioneve të syrit, endokardit, infeksioneve në fibrozën cistike, dhe infeksioneve të pajisjeve mjekësore të vendosura.

**10.** Produkti për përdorim siç pretendohet në secilin prej pretendimeve 8 ose 9 ku infeksioni është prej një mjedisi mukolitik.

**11.** Produkti për përdorim siç pretendohet në pretendimin 10 ku infeksioni është një infektion bakterial i lidhur me fibrozën cistike.

**12.** Produkti për përdorim siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 8 deri në 11 ku infeksioni shkaktohet nga një bakter zgjedhur nga grupi i përbërë prej *Pseudomonas spp.*, *Staphylococcus spp.*, *Haemophilus spp.*, *Burkholderia spp.*, *Streptococcus spp.* dhe *Propionibacterium spp.*

**13.** Produkti për përdorim siç pretendohet në pretendimin 12 ku bakteri është *Pseudomonas spp.*, *Burkholderia spp.* ose *Staphylococcus spp.*

**14.** Një produkt për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 13 ku agjenti antibiotik dhe agjenti i dytë administrohen në një mënyrë të kombinuar ose sekuenciale.

(11) **9901**

(97) EP3328182 / 18/11/2020

(96) 16745452.9 / 27/07/2016

(22) 16/02/2021

(21) AL/P/ 2021/120

(54) **MAKINERI RROTULLUESE ME SHUME FUNKSIONE**

06/05/2021

(30) UB20152738 31/07/2015 IT

(71) Rost Srl

36 Centro Abitato Maestà, 62010 Urbisaglia (MC), IT

(72) FIORANI, Stefano (44 Contrada Illuminati, 62010 Urbisaglia (MC))

(74) Vladimir NIKA

Bul " Bajram CURRI", Pall.2, Shk.3, Ap.4, Tiranë

(57) 1. Makineri rrotulluese me shumë funksione (100; 200; 300) për lëvizjen e dheut dhe/ose formimin e brazdave që përfshin;

- një shasi kryesore (1),
- mjete lëvizëse (2) të lidhura me shasinë kryesore (1) për mbështetjen dhe lëvizjen e makinës,
- një njësi veglash (3) për të lëvizur dheun dhe/ose për të formuar brazda; njësia e veglave (3) që përmban një bosht (31) të montuar në mënyrë të rrotullueshme në mënyrë të tillë që të rrotullohet rreth një aksi (R), bucelën (32) të vendosur në skajet e boshtit (31) dhe thikat (33) për të punuar tokën,
- mjetet e aktivizimit (7) të njësive së veglave për të vënë në rrotullim boshtin e përmendur (31) të njësive së veglave,
- një kornizë lidhëse (4) e lidhur me shasinë kryesore (1) në atë mënyrë që të dal frontalisht nga korniza kryesore,
- një shufër vertikale (8) që mban njësinë e veglave në fjalë (3), ku shufra vertikale e përmendur (8) është e lidhur në mënyrë rrotulluese me kornizën e përmendur lidhëse (4), në atë mënyrë që shufra vertikale (8) të rrotullohet rreth një aksi rrotullimi (Y ) që përkon me aksin gjatësor të shufrës vertikale (8), dhe
- mjetet e aktivizimit (9) të shufrës vertikale të lidhur me shufrën vertikale të përmendur (8) që e lënë shufrën vertikale (8) të rrotullohet rreth aksit të saj të rrotullimit (Y), në mënyrë të tillë për të lëvizur njësinë e veglave (3) në pozicione të ndryshme;

**karakterizuar në atë që**

thikat (33) dalin në mënyrë radiale nga secila bucelë (32), ku aksi (31) i njësive së veglave në fjalë (3) është një aks horizontal, dhe shufra vertikale (8) mban njësinë e veglave (3) në mënyrë të tillë që një rrotullim i shufrës vertikale (8) të shkaktojë një rrotullim të aksit të rrotullimit (R) të njësive së veglave (3) rreth aksit të përmendur të rrotullimit (Y) të shufrës vertikale (8), në atë mënyrë që të ndryshoj gjerësinë e seksionit të tokës që preket nga veprimi i njësive së veglave.

2. Makineri rrotulluese (100; 200; 300) sipas pretendimit 1, ku mjetet lëvizëse të përmendura (2) përmbajnë një bosht (21) të montuar në mënyrë të lëvizshme në shasinë kryesore (1) dhe makineria rrotulluese e përmendur (100; 200; 300) përmban mjetet e aktivizimit (M) të mjeteve lëvizëse për rrotullimin e boshtit të përmendur (21) të mjeteve lëvizëse.

3. Makineri rrotulluese (100; 200; 300) sipas pretendimit 2, ku mjetet lëvizëse në fjalë (2) përmbajnë:

- të paktën një bucelë (22) e bashkuar në boshtin e përmendur (21) të mjeteve lëvizëse, dhe
- thikat (23) që dalin në mënyrë radiale nga të paktën një bucelë (22) e mjeteve lëvizëse për t'u mbajtur në tokë.

4. Makineri rrotulluese (100; 200) sipas cilitdo prej pretendimeve paraardhëse, ku mjetet e aktivizimit të përmendura (9) të shufrës vertikale përmbajnë:

- një manivelë (6) e fiksuar në shufrën vertikale (8), dhe
- një shufër lidhëse (5) e lëvizshme në manivelin (6) për të lëvizur manivelin (6).

5. Makineri rrotulluese (100) sipas pretendimit 4, që përfshin mjete bllokimi (S) të lidhura me shasinë kryesore në fjalë (1) për të bllokuar shufrën lidhëse (5) në pozicione të ndryshme, në atë mënyrë që njësia e veglave (3) të mund të jetë në pozicione të ndryshme.

6. Makineri rrotulluese (100) sipas pretendimit 5, ku shufra lidhëse e përmendur (5) përmban një shumicë vrimash (F1, F2, F3, F4); ku mjetet e bllokimit në fjalë (S) përmbajnë një suport (S1) me një vrimë (S2) dhe një kunj (C) që futet në një vrimë të shufrës lidhëse dhe në vrimën mbajtëse.

7. Makineri rrotulluese (200) sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri në 5, ku mjetet e aktivizimit në fjalë (9) të shufrës vertikale (8) përmbajnë një veprues (90) të përshtatshëm për lëvizjen e shufrës vertikale të përmendur (8) automatikisht.

8. Makineri rrotulluese (300) sipas cilitdo prej pretendimeve 1 deri në 3, ku mjetet e aktivizimit të përmendura (9) të shufrës vertikale (8) përmbajnë një veprues (90) të përshtatshëm për lëvizjen e shufrës vertikale të përmendur (8) automatikisht; ku vepruesi (90) përmban një motor elektrik; motori elektrik i përmendur ka një bosht që përkon me shufrën vertikale të përmendur (8) në atë mënyrë që motori elektrik në fjalë e aktivizon drejtpërdrejt shufrën vertikale të përmendur (8).

9. Makineri rrotulluese (300) sipas pretendimit 8, që përmban gjithashtu një veprues të dytë (42) i përbërë nga një motor elektrik që përmban një bosht (43) të lidhur me shufrën (40) të kornizës lidhëse (4) në mënyrë që të rrotullohet korniza lidhëse në fjalë rreth një aksi horizontal (X) në pozicion ortogonal në lidhje me aksin e rrotullimit (Y) të shufrës vertikale (8).

(11) **9905**

(97) EP3219727 / 16/12/2020

(96) 16160918.5 / 17/03/2016

(22) 18/02/2021

(21) AL/P/ 2021/126

(54) **ANTITRUPA ANTI-TNF ALFA DHE FRAGMENTE FUNKSIONALË TE TYRE**

06/05/2021

(30)

(71) Tillotts Pharma AG

Baslerstrasse 15, 4310 Rheinfelden, CH

(72) GUNDE, Tea (Turbinenstrasse 33, 8005 Zuerich); MEYER, Sebastian

(Kirchrainstrasse 6, 5445 Eggenwil); FURRER, Esther Maria (Langwisenstrasse 28, 8103 Unterengstringen)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD, Rr. Pjeter BOGDANI, P.20/4, Ap.7/5, Tirane, 100

1. (57) Një antitруп ose një fragment funksional i tij i aftë të lidhet me faktorin alfa te nekrozës tumorale (TNF $\alpha$ ), ku antitрупi në fjalë ose fragmenti funksional përfshin (i) një domein V<sub>L</sub> që ka sekuencën amino acide të treguar ne SEQ ID NO:22 dhe SEQ ID NO:24, dhe (ii) një domein V<sub>H</sub> që ka sekuencën amino acide të treguar ne SEQ ID NO:21.
2. Fragmenti funksional i secilit nga pretendimet e mëparshme, që është një fragment i ndryshueshëm me zinxhir tek (scFv).

3. Fragmenti funksional i pretendimit 2, ku scFv në fjalë ka një sekuençë amino acide të zgjedhur nga grupi që perbehet treguar në SEQ ID NO:25 dhe SEQ ID NO:27 .
4. Antitropi i pretendimit 1, që është një immunoglobulinë G (IgG).
5. Një acid nukleik që kodon antitropin ose fragmentin funksional të secilit nga pretendimet e mëparshme.
6. Një vektor ose plasmid që përfshin një acid nukleik të pretendimit 5.
7. Një qelizë që përfshin acidin nukleik të pretendimit 5 ose vektorin ose plasmidin e pretendimit 6.
8. Një metodë e përgatitjes së antitropit ose fragmentit funksional të secilit nga pretendimet 1 deri në 4, që përfshin kultivimin e qelizës së pretendimit 7 në një mjedis në kushte që lejojnë shprehjen e acidit nukleik që kodon antitropin ose fragmentin funksional, dhe rikuperimin e antitropit ose fragmentit funksional nga qelizat ose nga mjedisi.
9. Një përbërje farmaceutike që përfshin antitropin ose fragmentin funksional të secilit nga pretendimet 1 deri në 4, dhe opsionalisht një mbartës dhe/ose mbushës farmaceutikisht të pranueshëm.
10. Antitropi ose fragmenti funksional siç është përcaktuar në secilin nga pretendimet 1 deri në 4 për përdorim në një metodë të trajtimit të një çrregullimi inflamator.
11. Antitropi ose fragmenti funksional për përdorim sipas pretendimit 10, ku çrregullimi inflamator në fjalë është një çrregullim inflamator i traktit gastrointestinal.
12. Antitropi ose fragmenti funksional për përdorim sipas pretendimit 11, ku çrregullimi inflamator në fjalë i traktit gastrointestinal është sëmundja inflamatore e zorrëve.
13. Antitropi ose fragmenti funksional për përdorim sipas pretendimit 11 ose 12, ku çrregullimi inflamator në fjalë i traktit gastrointestinal është sëmundja Crohn ose koliti ulçerativ.

(11) **9906**

(97) EP3239134 / 23/12/2020

(96) 17152492.9 / 29/01/2014

(22) 18/02/2021

(21) AL/P/ 2021/127

(54) **AMIDE PIRIDONI SI MODULATORË TË KANALEVE TË NATRIUMIT**

06/05/2021

(30) 201361759059 P 31/01/2013 US

(71) Vertex Pharmaceuticals Incorporated

50 Northern Avenue, Boston, MA 02210, US

(72) ARUMUGAM, Vijayalaksmi (506 Camino De La Paz, San Marcos, CA 92078);

ANDERSON, Corey (9534 Carroll Canyon Rd, No. 130 Unit 502, San Diego, CA 92126);

ASGIAN, Iuliana, Luci (8283 Torero Pl., San Diego, CA 92126); BEAR, Brian, Richard


(7010 Sitio Corazon, Carlsbad, CA 92009); TERMIN, Andreas, P. (2080 Wandering Road,

Encinitas, CA 92024); JOHNSON, James, Philip (1351 East 12th Avenue, Vancouver, British Columbia V5 N2 A1) ;HADIDA RUAH, Sara, Sabina (2356 Torrey Pines Road, No. 16, La Jolla, CA 92037)


(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania LTD , Rr. Pjeter BOGDANI, P.20/4, Ap.7/5, Tirane, 100

14. (57) Një komponim i formulës I ose I'



I



I';

ku, në mënyrë të pavarur për secilën shfaqje:

X është një lidhje ose C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil ku i përmenduri C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil është zëvendësuar me 0-6 halogjene, ku deri në 2 njësi CH<sub>2</sub> jo-fqinje të të përmendurit C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil mund të zëvendësohen me -O-;

R<sup>x</sup> mungon, H, ose C<sub>3</sub>-C<sub>8</sub> cikloalifatik, ku deri në dy njësi CH<sub>2</sub> të të përmendurit C<sub>3</sub>-C<sub>8</sub> cikloalifatik mund të zëvendësohen me -O- dhe i përmenduri C<sub>3</sub>-C<sub>8</sub> cikloalifatik është i zëvendësuar me 0-3 zëvendësues të përzgjedhur nga halogjeni dhe C<sub>1</sub>-C<sub>4</sub> alkili;

R<sup>1</sup> është H, halogjen, CN, ose C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil ku i përmenduri C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil është zëvendësuar me 0-6 halogjene dhe ku deri në dy njësi CH<sub>2</sub> jo-fqinje të të përmendurit C<sub>1</sub>-C<sub>6</sub> alkil mund të zëvendësohen me -O-;

